Nr. 503 Prot
Dt. 09.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
|SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
HOTELERI - TURIZEM"

RREGULLORE
E
QEVERISË TË NXËNËSVE
TË
INSTITUCIONIT
"HOTELERI-TURIZEM"

“Më thuaj dhe do ta harroj; më trego dhe mbase mbaj mend; më përfshijë dhe mua dhe unë do të kuptoj.”

Konfuci

Neni 1

Rregullorja e Qeverisë të Nxënësve të institucionit “Hoteleri-Turizem “këtu e më poshtë Qeveria, mbështetet në Ligjin nr. 15/2017 datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 759, datë 30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 25, datë 2.8.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 22, datë 04.10.2019 si dhe në Rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 2

Juridiksioni

Kjo Rregullore zbatohet brenda institucionit dhe e shtrin veprimtarinë e saj mbi Qeverinë e Nxënësve si dhe të gjithë nxënësit që kanë fituar këtë status në Institucionin“Hoteleri-Turizem “

Nxënësit kanë të drejtë të organizojnë qeverinë e nxënësve, e cila është një organizim i pavarur i nxënësve të Institucionit “Hoteleri-Turizem “ dhe nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Kjo Qeveri promovon pjesëmarrjen e nxënësve dhe koordinon përfaqësimin e ideve dhe opinioneve të tyre në organet drejtuese të Institucionit në strukturat mësimore, praktike dhe të shërbimeve.

Çdo aspekt tjetër i cili nuk është parashikuar në këtë rregullore, rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe akteve nënligjore të brendshme të tjera të institucionit.

Neni 3

Misioni

Qeveria e nxënësve është një organizëm i ngritur në çdo shkollë dhe ka për mision:

a) të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e nxënësve;

b) të kontribuojë në plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;

c) të ndihmojë në mbarëvajtjen e shkollës;

d) të përfaqësojë nxënësit e shkollës në marrëdhëniet me drejtorinë e shkollës, komunitetin dhe nxënësit e shkollave të tjera.

Neni 4

Funksioni i qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloren e brendshme të shkollës dhe rregulloren e saj.
Rregullorja e qeverisë së nxënësve hartohet nga grupe pune me nxënës dhe miratohet nga qeveria e saj pasi është marrë pëlqimi nga bordi dhe drejtori i shkollës.
Qeveria e nxënësve ka nënkryetarin dhe sekretarin, të cilët zgjidhen në mbledhjen e parë të saj.
Anëtarët e qeverisë së nxënësve kanë detyra që mbulojnë aspekte të veçanta të veprimtarisë së shkollës, si dhe klasa të caktuara, veçanërisht të fillores për qeverinë e nxënësve të arsimit bazë.
Qeveria e nxënësve informon rregullisht nxënësit për veprimtarinë e saj.
Qeveria e nxënësve:
a) harton dhe zbaton planin e saj vjetor në bashkëpunim me nxënës të shkollës;
b) përgatit raportin vjetor të veprimtarisë së saj, të cilin ia dërgon drejtorisë, kryetarit të bordit dhe kryetarit të këshillit të prindërve dhe mundëson leximin e këtij raporti nga nxënësit e shkollës.

Neni 5

Përbërja e Qeverisë së Nxënësve

Qeveria e nxënësve organizohet në nivel institucioni me përfaqësues nga të gjitha klasat/drejtimet dhe profilet përbërëse.
Anëtar i Qeverisë mund të jetë çdo nxënës aktual i institucionit pavarësisht gjinisë, racës, përkatësisë fetare, gjendjes fizike, ekonomike apo sociale.
Anëtarët e Qeverisë janë vullnetarë.
Struktura organizative e Qeverisë së nxënësve përbëhet nga:
1. Kryetari
2. Zv/Kryetari
3. Sekretari
4. Anëtarët

Zgjedhjet për qeverinë e nxënësve bëhen në fillim të çdo viti mësimor.

Neni 6

Kryetari i Qeverisë së Nxënësve

Menjëherë pas verifikimit të legjitimitetit të anëtarëve të Qeverisë zhvillohet procedura për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese të saj.
Kandidatët për Kryetarë të Qeverisë vet kandidohen duke plotësuar Formularin e Kandidimit (Aneksi 1 i kësaj rregulloreje) dhe më pas votohen nga të gjithë anëtarët me votim të fshehtë.
Kryetari i qeverisë zgjidhet një nga anëtarët e qeverisë, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të nxënësve të shkollës, me konkurrimin e më shumë se një kandidati për rolin e kryetarit.
Kryetari i qeverisë së nxënësve duhet të përzgjidhet nga klasat 10-11.
Kryetari i qeverisë nuk duhet të ketë lidhje familjare me drejtorin e shkollës.
Kryetari i Qeverisë ka një mandat 1 vit.
Kryetari shkarkohet nga ky pozicion me 4/5 e votave të anëtarëve të Qeverisë.

Neni 7

Funksionet e Kryetarit

Kryetari i Qeverisë së nxënësve:
a) drejton veprimtarinë e qeverisë së nxënësve
b) drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve
c) drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve ;
d) është përfaqësues i nxënësve në bordin e shkollës ;
e) përfaqëson nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë saj .

Neni 8

Zëvendës Kryetari

Kryetari i zgjedhur i Qeverisë së bashku me anëtarët e qeverisë zgjedhin një zëvendës kryetar, i cili votohet dhe më pas shërben si urë lidhëse mes institucionit dhe Qeverisë.
Zëvendëskryetari bashkëpunon me Kryetarin për realizimin e detyrave të Qeverisë;
Ai thirret për këshillim nga Kryetari sa herë shihet e nevojshme.
Në rast se Kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, ai autorizon zëvendëskryetarin për kryerjen e tyre.
Zv/ Kryetari ka një mandat 1 vit.
Zv/ Kryetari shkarkohet nga ky pozicion me 3/5 e votave të anëtarëve të Qeverisë të Nxënësve.

Neni 9

Sekretari i Qeverisë

Sekretari i Qeverisë propozohet nga Kryetari. Propozimi i tij miratohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Qeverisë.
Sekretari i Qeverisë ka për detyrë mbajtjen e një procesverbali mbi zhvillimet e mbledhjes, votimin, çështjet që u diskutuan, miratuan ose rrëzuan. Sekretari gjithashtu lajmëron të gjithë anëtarët mbi planin ditor dhe vjetor. Sekretari ka për detyrë të mbajë dhe procesverbalin e pjesëmarrjes se anëtarëve në mbledhje.
Sekretari i Qeverisë duhet të mbajë në regjistër dhe në formë kompjuterike emrat dhe të dhënat e të gjithë anëtarëve.
Sekretari ka një mandat deri në 1 vit
Sekretari shkarkohet nga ky pozicion me 3/5 e votave të anëtarëve të Qeverisë të Nxënësve.

Neni 10

Anëtarët

Nxënësit që aspirojnë të jenë anëtarë të Qeverisë duhet të kandidojnë nëpërmjet Formularit të Kandidimit, aneks i kësaj rregulloreje.
Anëtarët e qeverisë së nxënësve zgjidhen çdo vit nga votat e nxënësve aktual të institucionit, sipas kësaj procedure:
a) Kur një klasë ka vetëm një deri në katër paralele, nxënësit, nën kujdesin e mësuesve kujdestarë përkatës, zgjedhin për çdo klasë paralele nga një anëtar të qeverisë së nxënësve.
b) Kur një klasë ka më shumë se katër paralele, çdo klasë paralele, nën kujdesin e mësuesit kujdestar përkatës, zgjedh me shumicë votash dy nxënës, të cilët formojnë së bashku përfaqësuesit e paraleleve të një klase.
Përfaqësuesit e paraleleve të një klase, nën kujdesin e një mësuesi të caktuar nga drejtori, zgjedhin me shumicë të thjeshtë votash të fshehta, katër anëtarë të qeverisë së nxënësve.

Neni 11

Humbja e anëtarësisë

Anëtarët e Qeverisë e humbasin të drejtën e anëtarit nëse:

a) Anëtari revokon anëtarësinë me vullnetin e tij, nëpërmjet dorëheqjes nga posti dhe një kërkese me shkrim drejtuar sekretarit të Qeverisë.
b) Nuk përmbush kriteret e anëtarit (humbet statusin e nxënësit të institucionit).

c) Nëse nuk merr pjesë 3 herë radhazi në mbledhjet e Qeverisë ose ½ së mbledhjeve gjatë gjithë vitit.
d) Ndryshimi i shkollës përben kriter për humbjen e anëtarësisë.
dh) Kryen veprime që bien në kundërshtim me interesat e Qeverisë apo insititucionit.

Neni 12

Mësuesi ndihmës

Qeveria e nxënësve:
a) përzgjedh mësuesin ndihmës, i cili e ndihmon në hartimin dhe zbatimin e veprimtarive të saj dhe, në veçanti, në hartimin e rregullores së qeverisë së nxënësve;
b) kërkon zëvendësimin e mësuesit ndihmës të saj kur mësuesi ndihmës nuk kryen detyrat e tij.
Drejtori i institucionit emëron mësuesin ndihmës.

Neni 13

Të drejtat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka të drejtë:
a) të parashtrojë shqetësimet e saj për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve të shkollës dhe propozimet për mbarëvajtjen e shkollës te drejtori i shkollës, këshilli i mësuesve, këshilli i prindërve dhe bordi i shkollës;
b) të ketë një vend në shkollë ku të afishojë lajmërimet e veta;
c) të botojë gazetën e qeverisë së nxënësve;
d) të bashkëpunojë me qeveri homologe nxënësish për organizimin e veprimtarive të përbashkëta;
e) t'i drejtohet komisionit të etikës dhe sjelljes të shkollës dhe çdo organizimi tjetër për çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral te nxënësit në mjediset e shkollës.

Neni 14

Detyrat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka për detyrë:
a) të organizojë veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës;
b) të organizojë veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës;
c) të organizojë veprimtari që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset vendimarrëse;

d) të organizojë veprimtari që edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike;
e) të kontribuojë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës-nxënës, nxënës-mësues;
f) të kontribuojë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, si dhe të braktisjes së shkollës;
g) të kontribuoj në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale Brenda dhe jashtë shkollës;
h) të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet grup mosha e tyre;
i) të zgjedhë një herë në dy vjet nxënësit e shkollës, që do të kandidojë për Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë, nga kuotat e përcaktuara për kategoritë e veçanta të nxënësve.

Neni 15

Mbledhjet e Qeverisë

Qeveria mblidhet të paktën 1 herë në muaj. Mbledhjet kryhen javën e parë të çdo muaji. Data, ora, vendi i mbledhjeve dhe rendi i ditës i njoftohet të gjithë anëtarëve të Qeverisë, nga Sekretari i cili merr masa për afishimin e njoftimit në një vend të përshtatshëm.
Mbledhjet kryhen vetëm nëse janë të pranishëm 3/5 të të gjithë anëtarëve të Qeverisë. Në rast se ky kuorum nuk realizohet mbledhjet shtyhen në një datë të mëvonshme por jo më vonë se 1 javë nga data e paracaktuar e mbledhjes.
Mbledhjet çelen dhe drejtohen nga Kryetari i Qeverisë dhe në mungesë nga Zv/ Kryetari i paracaktuar nga Kryetari.
Të gjithë anëtarët e Qeverisë kanë të drejtë të dëgjohen, shprehin ide/opinione apo sugjerime për rendin e ditës dhe çështjet në diskutim.
Në përfundim të mbledhjes Kryetari nxjerr konkluzionet përkatëse apo fton për votim anëtarët për çështje të cilat janë diskutuar gjatë mbledhjes.
Mbledhjet e jashtëzakonshme mblidhen nëse thirren nga Kryetari ose ¼ e anëtarëve të Qeverisë me kërkesë drejtuar sekretarit të përgjithshëm.

Neni 16

Publiciteti i mbledhjeve

Mbledhjet e Qeverisë, si rregull, bëhen të hapura. Mbledhja quhet e hapur kur personeli mësimor, nxënës, ose të ftuar janë të lejuar ta ndjekin atë.
Qeveria me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, mund të vendosë që mbledhjet e saj ose pjesë të tyre të bëhen të mbyllura.

Neni 17

Procesverbalet e mbledhjeve

Në mbledhjet e Qeverisë mbahet procesverbal i përmbledhur nga Sekretari i Përgjithshëm.
Në procesverbalin e përmbledhur shënohet data e zhvillimit të mbledhjes, çështja që shqyrtohet, pjesëmarrja e anëtarëve dhe e të ftuarve, përmbledhja e diskutimeve të bëra, qëndrimet dhe rezultati i votimit. Procesverbali i përmbledhur paraqitet në mbledhjen më të parë pasardhëse të Qeverisë. Në rast se në mbledhjen e Qeverisë nuk ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes paraardhëse, procesverbali quhet i pranuar dhe nëse kërkohet votim, ai zhvillohet me ngritjen e dorës. Për proces verbalin fjala u jepet vetëm atyre anëtarëve të Qeverisë që kërkojnë të propozojnë korrigjim ose të sqarojnë mendimin që kanë shprehur.
Në çdo rast procesverbalet e përmbledhura të mbledhjes, me përjashtim të atyre që përmbajnë informacion të klasifikuar sekret, bëhen publike dhe u shpërndahen nxënësve të tjerë të interesuar.

Neni 18

Votimi i vendimmarrjes

Në përfundim të mbledhjeve të përcaktuara mund të merren vendime të cilat duhet të votohen paraprakisht nga anëtarët e Qeverisë.
Votimi është individual.
E drejta e votës nuk delegohet.
Votimi bëhet i hapur ose i fshehtë.
Me fillimin e votimit nuk lejohet të bëhen më diskutime dhe as i jepet fjala ndokujt deri në shpalljen e rezultatit të votimit. Votimi nuk ndërpritet për asnjë arsye
Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike.
Votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat. Fleta e votimit të fshehtë duhet të përmbajë të paktën objektin e votimit dhe alternativat e votimit pro, kundër dhe abstenim. Në fletën e votimit anëtari shënon me një shenjë të dallueshme dhe të qartë për zgjedhjen e bërë në alternativën për të cilën është dakord.
Rezultati i votimit në mbledhje shpallet nga drejtuesi i seancës, duke përdorur togfjalëshin “Miratohet nga Qeveria” ose “Nuk miratohet nga Qeveria”.

Neni 19

Sjellja dhe rregulli në Qeveri

Anëtarët e Qeverisë nuk duhet të ndërpresin fjalën e drejtuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe jo etike, të ndërmarrin sulme

personale apo veprime ndaj ndonjë anëtari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë.

Neni 20

Drejtori i Shkollës dhe Qeveria e Nxënësve

Drejtori i shkollës ka për detyrë:

a) t'i verë në dispozicion qeverisë së nxënësve dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e saj dhe të shkollës, si ligji për sistemin arsimor parauniversitar, dispozitat normative dhe akte të tjera nënligjore;
b) të takojë një herë në dy muaj qeverinë e nxënësve për të dëgjuar shqetësimet dhe propozimet e saj;
c) t'i sigurojë qeverisë së nxënësve një mjedis ku të zhvillojë veprimtaritë e saj, të ruajë arkivin e saj dhe të caktojë një vend ku qeveria e nxënësve të afishojë lajmërimet;
d) të përfshijë përfaqësues të qeverisë së nxënësve në grupet e punës që hartojnë rregulloren e shkollës, planin afatmesëm dhe planin e saj vjetor;
e) të ftojë kryetarin në mbledhje të këshillit të mësuesve, kur shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me kontributin e qeverisë së nxënësve.

Detyrimet e qeverisë së nxënësve ndaj drejtorit të shkollës:

a) Kryetari i qeverisë së nxënësve i kërkon leje me shkrim drejtorit të shkollës për veprimtari jashtë kurrikulare të qeverisë së nxënësve, të cilat i organizon në mjediset e shkollës ose jashtë saj.

Neni 21

Hyrja në fuqi e rregullores

Kjo rregullore hyn në fuqi pasi votohet nga shumica e thjeshtë e numrit total të nxënësve të institucioni.

KRYETARI I QEVERISË SË NXËNËSVE **DREJTORI I INSTITUCIONIT**

_____

ANEKS 1

FORMULAR KANDIDIMI PËR ANËTARË NË QEVERINË/ KËSHILLIN E NXËNËSVE

KANDIDATI _____
(emër, mbiemër)

KLASA _____

VITI _____

PROFILI I KURSIT _____

MOTIVI I KANDIDIMIT

_____
_____
_____
_____
_____

OBJEKTIVAT E SYNUARA

_____
_____
_____
_____
_____

NËNSHKRIMI I KANDIDATIT

_____

ANEKS 2

FORMULAR KANDIDIMI PËR KRYETARË NË QEVERINË/ KËSHILLIN E NXËNËSVE

ANËTARI_____
(emër, mbiemër)

KLASA _____

VITI _____

PROFILI I KURSIT _____

MOTIVI I KANDIDIMIT

_____
_____
_____
_____
_____

OBJEKTIVAT E SYNUARA

_____
_____
_____
_____
_____

LAJTMOTIVI I JETËS

_____
_____
_____

NËNSHKRIMI I ANËTARIT

_____